

RAPORTE JO TEKNIK

RAPORTE JO TEKNIK

Subjekti : IDS DETERGENT

Përmbledhja Jo Teknike



Adresa : "Ish Kombinati Metalurgjik", uzina 12, ELBASAN

Administrator Ejup Sula

IDS Detergenti sh.p.k

Nipt. L53602288L

Uzina 12 ish Kombinati Metalurgjik, 3601 Elbasan

www.idsdetergenti.com

e-mail: info@idsdetergenti.com

Dhjetor 2021

RAPORTE JO TEKNIK

1.Përshkrimi I Aktivitetit

Subjekti Jone operon në treg nga viti 02/12/2015 e deri me sot. Ne ofrojmë klientëve tanë , prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te detergjenteve per perdorim familjar me nje cilesi mjaft te larte dhe cilesor. Objekti ku janë instaluar linjat teknologjike për prodhimin e detergjentëve pluhur dhe të lëngshm, është pjesë e Ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan. Hapësirat e brendëshme të objektit dhe ato jashtë tij, janë të mjaftueshme për zhvillimin normal të proceseve teknologjike, magazinimin e lëndëve të para dhe të produkteve si dhe për qarkullimin e lirë të mjeteve të transportit dhe personelit punonjës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të prodhojë produktet dhe nënproduktet e detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm, për përballimin e kërkesave të sektorit familjar dhe bizneseve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

1.2 Tematikata e perdorura per subjektin Prodhim Detergjentesh

- Shpjegimi rreth termave të përdorura në këtë dokument është bërë bazuar në Nenin nr.2. Përkufizime, të Ligjit Nr. 10 216, datë 21.01.2010 “PËR DETERGJENTËT”

√ “Detergjent” është çdo substancë ose preparat, në formë të lëngët, pluhuri, paste, kallëpi, blloku, figure etj., që përmban sapune dhe/ose lëndë të tjera tensioaktive, i destinuar për t’u përdorur në proceset e larjes dhe të pastrimit, si dhe tregtohen dhe/ose përdoren për qëllime shtëpiake ose industrial.

RAPORTE JO TEKNIK

Detergjentë vlerësohen edhe produktet e mëposhtme:

“**Preparat ndihmës për larje**”, i përcaktuar për njomje (paralarje), shpëlarje ose zbardhje rrobash, tekstilesh për përdorim shtëpiak, etj.

“**Zbutës tekstilesh**”, i përcaktuar për të ndryshuar karakteristikat në prekje të tekstileve, në proceset që plotësojnë larjen e tyre;

“**Preparat pastrimi**”, i përcaktuar për pastruesit shtëpiakë, universalë dhe/ose pastrime të tjera sipërfaqesh.

“**Pastrim**” është largimi i një depozitimi të padëshirueshëm mbi dhe/ose në brendësi të substratit, që ndryshon disa karakteristika, pamjen ose ndjesinë e një sipërfaqeje të pastër.

“**Substanca**” janë elementët kimike dhe përbërjet e tyre siç gjenden në natyrë ose të përftuara nga çdo proces prodhimi, përfshirë çdo shtesë të nevojshme për të ruajtur stabilitetin e produkteve dhe çdo papastërti, si pasojë e procesit të përdorur, por duke përjashtuar çdo tretës, i cili mund të ndahet nga substanca, pa ndikuar në stabilitetin e saj ose pa ndryshuar përbërjen e saj

“**Preparat**” është përzierja ose tretësira, e përbërë nga dy ose më shumë substanca.

“**Lëndë tensioaktive**” është çdo substancë organike dhe/ose preparat, i përdorur në detergjentë, i cili vepron në sipërfaqe dhe përbëhet nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe një a më shumë grupe hidrofobe, të një natyre dhe me përmasa të tilla, që i japin aftësinë të zvogëlojë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër, të formojë emulsione dhe/ose mikroemulsione dhe/ose micela dhe të thithë në sipërfaqet e kontaktit ujë-trup i ngurtë.

“**Biodegradim**” është një proces, prej të cilit përbërjet kimike organike (përbërjet që përmbajnë karbon) zbërthehen në përbërje më të thjeshta kimike nën veprimin e mikroorganizmave në natyrë.

“**Vendosje në treg**” është bërja e disponueshme në treg e detergjentëve dhe e lëndëve tensioaktive për detergjentët për palët e treta, kundrejt pagesës ose falas. Importimi vlerësohet, gjithashtu, vendosje në treg.

“**Fabrikues**” është çdo person fizik ose juridik, përgjegjës për vendosjen në treg të detergjentëve ose të lëndëve tensioaktive për detergjentët. Gjithashtu, vlerësohet fabrikues përfaqësuesi i tij i autorizuar, prodhuesi, importuesi, paketuesi që punon për llogari të tij ose çdo person, që

RAPORTE JO TEKNIK

ndryshon karakteristikat e detergjentit a të lëndës tensioaktive të detergjentit, që krijon ose ndryshon etiketimin e tij, kur vetë fabrikuesi nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe shpërndarësi kur vepron si importues.


“Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.

2.Përshkrimi i vendndodhjes

"Ish Kombinati Metalurgjik", uzina 12, ELBASAN vitet e fundit po transformohet në një zonë të zhvilluar industriale, duke shfrytëzuar infrastrukturën inxhinjrike egzistuese si dhe duke kryer investime të rëndësishme në instalimin e teknologjive të reja prodhuese.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e prodhimit të detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm të shoqërisë "IDS DETERGENT" është i vendosur në pozicion të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit të Detergjenteve.

RAPORTE JO TEKNIK



Subjekti ka kryer investime në rikonstruksionin apo mirëmbajtjen e godinave, rrjeteve inxhinjrike, instalimin e makinerive e paisjeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë. Objekti është lidhur në mënyrë organike me rrjete inxhinjrike të kësaj zone industriale, në bazë të kontratave respektive me subjektet që administrojnë këto rrjete.

RAPORTE JO TEKNIK

√ *Furnizimi me energji elektrike*

Subjekti furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni elektrik i ish-uzinës. Rryma elektrike merret nga rrjeti nëntoksor me kabëll të përshtatshëm për rrymë dy dhe tre fazore. Brenda reparteve prodhuese janë ndërtuar rrjetet e brendëshme përkatëse për shpërndarjen e rrymës tre fazore në të gjitha makineritë dhe pajisjet e instaluar aty.

Po kështu është edhe rrjeti i brendëshëm i rrymës dy fazore e cila përdoret kryesisht për sistemet e ndriçimit të ambjenteve të punës, zyrave e pajisjeve të tyre, etj.

Të dy këto rrjete kanë pajisjet e duhura teknike të vënies në punë dhe të ndalimit të makinerive, pajisjet e mbrojtjes nga mbingarkesat e rrymës dhe të tensionit, lidhjeve tokëzuese, etj.

Subjekti ka të instaluar pajisje elektrike me fuqi që shkon në nivelet e 300 kWh.

√ *Furnizimi me ujë.*

Subjekti furnizohet me ujë të pijshëm dhe ujë industrial, nga rrjetet përkatëse të ish-kombinatit metalurgjik.

Brenda objektit ka një rrjet të brendëshëm të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe atij industrial në të gjitha pikat konsumatore të tij.

Uji industrial nuk është pjesëmarrës në asnjë prej proceseve teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari. Ai përdoret kryesisht për përdorim në ambjentet hidro-sanitare si dhe për pastrimin/larjen e ambjenteve të punës. Sasia mesatare e përdorimit të ujit është rreth 200. m³ /muaj.

√ *Furnizimi dhe konsumi i lëndëve djegëse.*

Karburante (naftë & benzinë).

Nafta dhe benzina përdoren nga mjetet e transportit që zotëron subjekti. Këto mjete transporti përdoren për transportin e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse, për transportin e prodhimeve të realizuar si dhe për transportin e punonjësve. Subjekti zotëron dhe shfrytëzon edhe disa mjete

RAPORTE JO TEKNIK

ngritëse e transportuese të cilat përdoren për transportet e materialeve të ndryshme, me peshë relativisht të mëdha brenda objektit. Në subjekt funksionojnë edhe autovetura e fugonë për transportin e personelit.

Sasitë e konsumit të naftës dhe benzinës shkojnë në nivelet e .100. litra/muaj.

2.2 Përshkrimi i veprimtarisë

Forma e lëngët për detergjentët shtëpiak po fiton gjithnjë e më shumë pjesë të tregut në shumë vende botërore veçanërisht, detergjentët për larjen e enëve dhe format e lehta të tyre. Produktet e kujdesit personal në formë të lëngshme zënë një pjesë të konsiderueshme të tregut dhe mund të prodhohen në të njëjtat impiante si detergjentët e lëngshëm. Për këtë arsye, sa herë që u referohemi detergjenteve të lëngshëm, mund t'u referohemi edhe produkteve të kujdesit personal.

Pavarësisht nga lloji i detergjentëve që synohen për t'u realizuar, prodhimi i detergjentëve në përgjithësi bazohet në procese teknologjike, pajisje dhe makineri si dhe përdorim të lëndëve të para dhe ndihmëse, në përputhje me kërkesat kimike dhe fizike që duhet të plotësojnë këto produkte. Detergjenti i prodhuar, në të cilin janë përfshirë përbërës të ndryshëm duhet të jetë i qëndrueshëm. Ky rezultat arrihet kur të gjithë përbërësit e formulimit (lëndëve të para dhe ndihmëse, pajisjet dhe parametrat teknologjikë). zgjidhen siç duhet dhe futja e tyre në recetën e produktit është e tillë që të shmangët një ndryshim i fortë i temperaturës, pH dhe viskozitetit, si dhe reaksioneve kimike të padëshirueshme.

Me fjalë të tjera, prodhimi i llojeve të përcaktuara të detergjentëve kërkon kujdes të madh në përcaktimin dhe formimin e "përzjerjeve" të qëndrueshëm të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse si dhe të shpërndarjes uniforme në produktin e kërkuar. Kjo zakonisht perceptohet si "homogjeniteti i produktit".

Kërkesat teknike dhe ato tregtare, që kushtëzojnë produktet e detergjentëve, pavarësisht nga fushta e përdorimit të tyre dhe/ose përdorimi specifik, mund të përmblihet si më poshtë:

- Pamja e bukur (ngjyra dhe shkalla e transparencës);
- Viskoziteti i kontrolluar

RAPORTE JO TEKNIK

- Stabiliteti kundrejt kohës së ruajtjes, temperaturës dhe efekteve të dritës;
- Paketimi i përshtatshëm dhe tërheqës është gjithashtu i një rëndësie të madhe.

Prodhimi i detergjentëve të llojeve të ndryshëm, mbështetet në një njohuri të mirë të treguesve fiziko-kimikë të përbërësve të detergjentit dhe aftësisë për të kontrolluar dhe modifikuar ndërveprimet e tyre, gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike respektive.

Impianti i prodhimit të detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm funksionon mbi bazën e një procesi të thjeshtë fiziko-kimik, i cili bën të mundur që lënda e parë agregate e detergjentëve, e cila vjen nga kompani të liçencuara dhe ka përmasa të kokrrizave të vogla dhe produkte të lëngëshme, i nënshtrohet proceseve fiziko-kimike në linjën e prodhimit të detergjenteve, duke përfutur në këtë mënyrë produktin e dëshiruar për tregun rajonal. Prodhimi i të gjitha llojeve të detergjenteve përfshin hapat e treguar në këtë skema:


- √ Mundësia për të përpunuar lëngje në një gamë të gjerë viskoziteti
- √ Mundësia e përdorimit të tretësve alkoolikë (domosdoshmëria e modelit anti-shpërthim);
- √ Bashkim i lehtë me një sistem të kompjuterizuar të kontrollit të procesit
- √ Përdorimi i materialeve me rezistencë të lartë dhe korrozioni (çelik inox dhe lidhje të veçanta);
- √ Aftësia për të siguruar shpejtësi të lartë të transferimit të nxehtësisë (si për ftohjen ashtu edhe për ngrohjen);
- √ Aftësia për të siguruar përzierje intime dhe të vazhdueshme;
- √ Mundësia për të korrigjuar pH, viskozitet dhe temperaturë (nga pajisje specifike);
- √ Mundësia e pastrimit të shpejtë dhe të thjeshtë (për të zvogëluar ndryshimin e produktit me kalimin e kohës) pa rrezik të ndotjes

RAPORTE JO TEKNIK

Hapat që ndiqen në impiantin e prodhimit të detergjenteve janë:

Në fillim hidhet ujë dhe pastaj sipas radhës hidhen lëndët e para duke vazhduar pandërprerë përzjrtjen deri në krijimin e një mase uniforme. Në vijim bëjmë analizën kimike përkatëse për vizkozitetin dhe pH dhe, në bazë të rezultatit të saj, bëjmë ose jo korigjimet e duhura. Në vartësi të produktit që kërkohet të realizohet, në vend të ujit, në vifillim hidhet një tretësisrë 3 % me NaOH. Në vartësi të përbërjes kimike të ujit (fortësisë së tij ose përmbajtjes së klorit, etj.), llogaritet sasia e produktit që do të realizojmë si dhe sasia e ujit plus hipo plus NaOH. E gjithë kjo tretësisrë i nështrohet më tej përzjerjes së bashku me lëndët e para dhe ato ndihmëse, që marrin pjesë në krijimin e produktit përkatës

Skema Teknoogjike



RAPORTE JO TEKNIK

Në përgjithësi, procesi i prodhimit është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik i linjës së prodhimit të detergjenteve. Për menaxhimin e materialeve pjesmarrës në proceset teknologjike dhe funksionimin e linjës së prodhimit të detergjenteve në një ditë të zakonshme pune, skema e funksionimit është relativisht e thjeshtë dhe emirëorganizuar nga drejtuesi ligjor i këtij subjekti. Drejtuesit teknik menaxhojnë të gjithë operacionet e punës së impiantit të prodhimit të detergjenteve, duke filluar nga regjistrimi i urdhërave të përditshëm, listën e kërkesave, llogaritjet teknologjike të prodhimit që kërkohet të realizohet, në përputhje me llojet dhe sasinë e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që duhet të përdoren, menaxhon kohët e dorëzimit dhe të shkarkimit, kontrollon dhe përmirëson gabimet e mundshme të identifikuar gjatë zhvillimit të procesit të prodhimit duke përdorur metodikat e miratura për çdo rast.

Drejtuesit teknikë të prodhimit bëjnë:

√ Kontrollin në kohë reale të ecurisë së parametrave teknikë të prodhimit dhe paraqitjen në grafikë visual, të prodhimit orar.

√ Kontrollin dhe koordinimin e plotë të të gjithë operacioneve teknologjike të prodhimit si psh dozimin në lloje dhe peshë të materialeve dhe energjive si dhe, ofrojnë informacione të vazhdueshme të konsumit të tyre

√ Ndjekin dhe drejtojnë një gamë të gjërë të programeve të prodhimit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si

i. Menaxhimit të Porosive, nëpërmjet:

- ♣ Administrimin e dokumenteve të procesi të ngarkimit të impiantit;
- ♣ Administrimin e dokumenteve të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual
- ♣ Menaxhimit të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse, hyrje ose dalje, gjendje në proces etj.
- ♣ Menaxhimit të përditshëm të prodhimit të realizuar, në sasi idhe lloje
- ♣ Kontrollit të parametrave të shfrytëzimit notmal të aftësive të linjës së prodhimit.
- ♣ Zbatimit të programeve të kontrolleve teknike dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të linjës teknologjike

RAPORTE JO TEKNIK

Punonjësit

- √ Kryejnë operacionet e ngarkim-shkarkimit të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse etj.
- √ Kontrollonjë, mirëmbajnë dhe kryejnë riparimet e mundëshme të pajisjeve të linjës teknologjike, aparaturave etj.
- √ Bëjnë rakordin e sasisë sëmaterialittë shkarkuar dheproduktit përfundimtar.
- √ Bëjnë transportimin dhe magazinimin e produkteve të realizuara dhe të ambalazuara.
- √ Bëjnë pastrimin e pajisjeve, të vendit të punës etj. në përfundim të ditës së punës.

Produktet kryesore të prodhimit të detergjenteve.

Në linjat teknologjike të këtij subjekti realizohet prodhimi i këtyre detergjentëve. Çdo njëri prej tyre ka përbërje cilësore të përcaktuar, e përcaktuar kjo nga:

- o Qëllimi për të cilin është realizuar çdo produkt;
- o Lëndët e para dhe ato ndihmëse që kanë marrë pjesë në formimin e tij;
- o Trajtimi fizik-kimik (parametrat teknologjikë) të cilit i janë nështruar lëndët e para dhe ato ndihmëse

RAPORTE JO TEKNIK

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar për të operuar dhe për të zhvilluar aktivitetin e prodhimit të detergjenteve pluhur dhe të lëngshëm, me të cilët ky subjekt është i pranishëm në tregun rajonal. Drejtuesit administrative dhe ata teknikë të prodhimit, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit prodhues, kujdesen të zbatohen të gjitha rregullat teknike, të shfrytëzimit të makinerive dhe linjave teknologjike si dhe kartët teknologjike të përgatitjes së llojeve të caktuara të detergjenteve të lëngët apo plohur. Njëkohësisht ata kërkojnë edhe zbatimin korrekt të rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, mbrojtjes së mjedisit etj

Në këtë veprimtari, veprimtaria prodhuese është e organizuar në menyre të tillë që, të funksionojë në formën e një organograme për realizimin sa më eficient dhe të sukseshëm, duke treguar mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të secilit. Përbërësit kryesorë të programit për menaxhimin e instalimit, me synim mbrojtjen e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Respektimi i orareve të punës për të gjithë punonjësit e kësaj veprimtarije
- Zbatimi me korrektësi i rregullores së brendshme si dhe të rregulloreve teknike.
- Vlerësimi i informacionit të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të qëndrueshëm dhe të mire
- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të Çertifikuara sipas Standarteve Europiane si dhe kontrolli teknik dhe kolaudimi periodik i tyre nga subjekte ekspertë liçensuar.
- Mirëadministrimi i ndikimeve potenciale ambientale, që mund të identifikohen gjatë zhvillimit të aktivitetit
- Trajtim i ujrave teknologjike të gjeneruara nga kjo veprimtari
- Propozimi dhe zbatimi i masave zbutese, të ndikimeve në mjedis.

RAPORTE JO TEKNIK

- Monitorimi i cilesise ajrit, i cilësisë së ujrave të shkarkuar, nivelit të zhurmës etj.
- Kryerja e trajnime specifike, për personelin punonjës.

Legjislacioni shqiptar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, parashikon përfshirjen e stafit drejtues teknik dhe administrativ, në procesin e identifikimit të rreziqeve të mundëshme në vendet e punës gjatë zhvillimit të veprimtarisë së çdo subjekti fizik dhe juridik, me qëllim shmangien apo/ose parandalimin e zhvillimit të tyre. Është detyrim ligjor për çdo subjekt fizik/juridik, hartimi dhe zbatimi i rregulloreve të mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe njohja e gjithë personelit punonjës të subjektit me këto rregullore duke bërë kështu që, punëtorët të kenë një rol thelbësor në parandalimin e rreziqeve si dhe në zgjedhjen dhe zbatimin e masave specifike për çdo tipologji procesi pune.

Drejtuesit teknik dhe administrativë të subjektit duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe pa kompromis për ndërgjegjësimin e punonjësve të tyre në njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurisë në punë, si dhe në azhurnimin e përhershëm me zhvillimin e legjislacionit përkatës.

Aksidentet në punë në shumicën e rasteve ndodhin, për shkaqe subjektive të lidhura me moszbatimin e rregullave teknike të shfrytëzimit të makinerive dhe pajisjeve si dhe të mos zbatimit të rregullave të mbrotjes dhe sigurisë në punë, mbrojtjes nga zjarri etj. Ky mos zbatim i rregullave të përcaktuara është i lidhur shpesh edhe me njohuritë e limituara që kanë punëtorët e pakualifikuar apo të pa trajnuar, në lidhje me proceset e punës, makineritë dhe pajisjet që ato përdorin etj.

RAPORTE JO TEKNIK



RAPORTE JO TEKNIK